



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:040541

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05794631

KPPP.nr. 1387/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbareme të kreditorit KRU “Prishtina” Sh.A me seli në Prishtinë kundër debitorit R.D. – Barnatore, me adresë në rr. “...” Ob..., nr... Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr. 107/21 të datës 25.01.2021, të lejuar nga Përmbaremi Privat Isa Gacaferi me zyre në Prishtinë, jashtë seancës me datë 07.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit R.D. – Barnatore ashtu që Urdhri Përmbareme P.nr. 107/21 i datës 25.01.2021, i lejuar nga Përmbaremi Privat Isa Gacaferi, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 25.01.2021 ka lëshuar urdhër përmbareme P.nr. 107/21, me të cilin e ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit Ekstrakt nga librat e kontabilitetit me shifrën K001925, duke urdhëruar debitorin R.D. – Barnatore, që në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike, t’ia paguaj kreditorit borxhin e përcaktuar sipas dokumentit të lartcekur në shumën prej 1,346.10 EUR (njëmijë e treqind e katër dhjetë e gjashtë euro e dhjetë euro cent) si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor duke kundërshtuar në tërësi Urdhrit për lejimin e përmbaremit me arsyetimin se borxhi i përfshirë në ekstraktin nga librat afarist është i parashkuar, pasi që ka kaluar afati një (1) vjeçar nga neni 360 i LMD-së, brenda të cilit afat kreditori ka mundur të kërkojë realizimin e borxhit. Gjykatës i ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbaremit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr. 294/21 të datës 01.04.2022 ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, ashtu që ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr. 107/2021 të datës 25.01.2021 për vlerën prej 361.36 EUR, ndërsa ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të prapësimit lidhur me borxhin e mbetur prej 984.74 EUR.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr. 5392/22 të datës 27.12.2022, ka aprovuar si të themeltë ankesën dhe ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 294/21 të datës 01.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke kthyer lëndën në procedim të serishëm. Në arsyetimin e saj ka theksuar se gjykata e shkallës së parë, gabimisht është lëshuar në vlerësimin e prapësimeve të natyrës materiale, kjo meqenëse në rastin konkret, propozimi për përmbartim ka përmbajtur të meta nga neni 38 i LPP-së, meqenëse nuk përmban kërkesën për përmbartim dhe periudhën brenda të cilit kërkohet përmbartimi.

Gjykata, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë vërejtjet sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr. 5392/22 të datës 27.12.2022, në kuptim të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Me nenin 38 të këtij ligji përcaktohet se *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*.

Duke iu referuar dispozitave të lartcekura dhe bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata konstaton se propozimi për përmbartim nuk i plotëson elementet kumulative të përcaktuara me nenin 38 të LPP-së fillimisht sa i përket emërimit dhe identifikimit të debitorit, kjo pasi që si debitor në ekstraktin nga librat afarist dhe në propozimin për përmbartim evidentohet “R.D. – Barnatore” por që nga këto të dhëna, nuk dihet se a kemi të bëjmë me debitor si person fizik apo kemi të bëjmë me debitor si shoqëri tregtare, kjo meqenëse dokumentit i mungon si numri personal, ashtu edhe numri i biznesit të debitorit.

Në anën tjetër, gjykata gjeti se dokumenti i besueshëm nuk përmban në mënyrë të qartë objektin e detyrimit të tij kjo meqenëse në hyrje të tij, evidentohet periudha kohore nga data 01.01.2013 e deri më datë 21.02.2021, ndërsa në përmbajtje të ekstraktit, janë të listuara faturat vetëm nga data 30.09.2014 e tutje, ashtu që shuma në vlerë prej 66.03 EUR e evidentuar si saldo, nuk dihet se cilës periudhë kohore i përket kjo meqenëse faturat mbi bazën e të cilave është krijuar kjo pjese e borxhit nuk janë të listuara në ekstraktin nga librat afarist. Në ndërlidhje me këtë, kreditori fare nuk ka përcaktuar se cila është periudha kohore brenda të cilit kërkohet realizimi i borxhit që derivon nga ekstrakti afarist.

Përkundër kësaj, Përmbartuesi Privat si organ përmbartues në këtë çështje përmbartimore, edhe pse ka qenë i obliguar që të kërkojë nga pala kreditore evitimin e të metave të propozimit për përmbartim, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 38, par.2 të LPP-së me të cilin parashihet se *“Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”*

Në këtë drejtim, referuar nenit 43, par.4 të LPP-së i cili përcakton se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*, gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbartimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimi për përmbartim nuk përmban në mënyrë të qartë palën debitore dhe nuk përmban në mënyrë të qartë objektin e detyrimit të tij.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1387/23, datë 07.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.